



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 125, Datë 04.04.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S 58, DATË 31.03.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TERFOJA”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 KW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3 të ligjit nr. 144/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1128/1 prot., datë 04.04.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi ndryshimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 58, datë 31.03.2023, “Licencimin e shoqërisë “HEC TERFOJA ” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “TERFOJA” me kapacitet të instaluar 1980 kW”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 58, datë 31.03.2022, ka vendosur të licencojë shoqërinë “HEC TERFOJA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfojë”; me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar, duke i lënë kusht që të depozitohet lejen e përdorimit të burimit ujor me afat të rinovuar, brenda datës 23.01.2023.
- Me shkresën nr. 175/10 prot., datë 20.12.2022, ERE i ka kujtuar shoqërisë detyrimin për të depozituar lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1128 prot., datë 24.03.2023, shoqëria ka bërë me dije se ka aplikuar sërish në datën 18.01.2023, pasi organi përgjegjës nuk mund të lëshonte faturën përkatëse pa marrë konfirmimin nga operatori i rrjetit për energjinë e prodhuar, dhe ka depozituar në ERE aplikimin për rinovimin e kësaj lejeje.
- Në korrespondencën që ERE ka zhvilluar me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), në lidhje me vlefshmërinë dhe rinovimin e lejeve të përdorimit të burimeve ujore

për prodhimin e energjisë elektrike, AMBU ka vlerësuar se në lidhje me HEC-et/subjektet, aplikimet e të cilëve për pajisje me leje apo rinovim të lejes ekzistuese janë në proces trajtimi nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, verifikimet dhe informimet do të bëhen në vijim.

- Për sa më sipër dhe në referencë të VKM-së nr. 550 datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor të rinovuar brenda 3 muajve nga data e aplikimit (18.01.2023), pra brenda datës 18.04.2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 2 e vendimit nr. 58, datë 31.03.2022, e bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet:
  2. *Shoqëria “HEC TERFOJA” sh.p.k. të depozitohet në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor të rinovuar brenda datës 18.04.2023.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**